

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -



EKO KLUBI "LORENC ANTONI"



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH ENVIRONMENTAL IMPACT




Të dashur lexues,

Kjo është seria e katërt e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Lorenc Antoni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësuesve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).




CILA ËSHTË RËNDËSIA E BIODIVERSITETIT?

22 Maji është Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit, ndërsa viti 2010 nga Kombet e Bashkuara është shpallur si viti ndërkombëtar i biodiversitetit. Kam përshtypjen se opinionit i mungojnë informatat për rëndësinë e biodiversitetit, rreziqet që po i kanosen dhe masat mbrojtëse që duhet të merren për ruajtjen e tij. Prandaj qëllimi i këtij artikulli është që shkurtimisht me disa të dhëna të njihet opinioni për këtë vlerë të pakrahasueshme të natyrës.

Biodiversiteti nënkupton larminë e gjeneve, të llojeve dhe të ekosistemeve në planetin tonë. Biodiversiteti është vlera më e lartë e natyrës, është baza e jetës tonë dhe themeli i zhvillimit të qëndrueshëm. Biodiversiteti është rezultat i evoluimit të jetës në Tokë gjatë miliarda vjetësh. Në plantën tonë, llogaritet se jetojnë rreth 13 milionë lloje të bimëve, kafshëve dhe mikroorganizmave, prej të cilave vetëm 1.75 milion janë të emërtuara dhe të përshkruara. Vlera e ekosistemeve nuk është vetëm ekzistenca-bazë për jetën e bimëve dhe kafshëve, por edhe për ne njerëzit. Shërbimet e vlerave të ekosistemeve të cilat nga natyra janë “falas”, janë esenciale për shëndetin tonë, sigurinë tonë ushqimore dhe shëndetësore dhe prosperitetin tonë.






CILA ËSHTË RËNDËSIA E BIODIVERSITETIT?

Hapësira e Kosovës edhe pse përfshinë një sipërfaqe të vogël të Ballkanit (rreth 2.4%), krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit dhe të Evropës, dallohet me resurse të shumta natyrore, pra edhe me vlera të larta të biodiversitetit. Kosova është shtëpia e rreth 2,500 llojeve të bimëve lulore, 210 lloje të egra të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave, 104 lloje kërpudhash etj. Ajo që biodiversitetin e Kosovës e bënë interesant dhe të rëndësishëm është prania e një numri të madh të llojeve endemike dhe relikte. Por fatkeqësisht biodiversiteti i Kosovës, këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, për arsye të ndryshme është dhe më i rrezikuari në Ballkan dhe Evropë.

Biodiversiteti në rrezik! - Çdo lloj i cili vdes dhe shkon nga bota jonë, është i pakthyeshëm, një burim natyror më pak. Biodiversiteti natyror nuk ka qenë kurrë më i atakuar se sa në dhjetëvjeçarët e fundit që lidhet me shumë faktorë: shumëfishimi i njerëzimit brenda një kohe të shkurtër, tej-eksplorimi i resurseve, ndotja e madhe etj. Humbjet e diversitetit biologjik janë drastike dhe fatkeqësisht shkatërrimet e ekosistemeve janë në rritje permanente. Njerëzit me ose pavetëdije janë duke bërë zhdukjen në masën më të madhe të biodiversitetit në historinë e Tokës.





CILA ËSHTË RËNDËSIA E BIODIVERSITETIT?

Në mbarë botën tashmë janë më shumë se 60% e ekosistemeve me rrezikshmëri të përhershme dhe një parashikim të numrit prej 15,600 llojeve që kërcënohen të zhduken. Në të gjithë botën si pasojë e veprimtarisë së faktorit njeri, çdo ditë zhduken lloje kafshësh dhe bimësh .

Rezultatet e raportit të një studimi Evropian, më 2008 tregon se në 300 vitet e fundit, në botë sipërfaqja e përgjithshme pyjore është tkurrur me 40%. Llogaritet se në çdo minutë zhduken rreth 20 hektar pyje. Në 25 vende të botës, pyjet janë zhdukur tashmë plotësisht. Prerja e një bime masa drunore e të cilit do të kushtonte rreth 500 euro është një humbje e madhe pasi që gjatë jetës së tij ky dru do të gjeneroj deri 1,900,000 euro përmes vlerave ekologjike siç janë: prodhimi i oksigjenit, pastrimi i ajrit, riciklimi i ujit, fertilizimi i tokës, kontrolli i erozionit, sigurimi i habitateve për botën e egër, zbutjen e efekteve toksike të gazeve, etj. Në botë që nga viti 1900 rreth gjysma e të gjitha kënetave janë të humbura.





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

EKO KLUBET MËSOJNË PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE PËR FORMAT E AVOKIMIT
MJEDISOR



AKTIVITETET E EKO- KLUBIT:

EC-I ME EKO-KLUBET SHËNOI DITËN BOTËRORE TË MJEDISIT



Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 12 Eko-Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (nga komunat Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë).

Shfaqja e filmit është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të Eko-Klubeve mbi çështjet mjedisore dhe urgjencën për veprim lidhur me ndryshimet klimatike, tema këto të trajtuara edhe në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti të rinjtë janë ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e një reagimi të shpejtë sikurse edhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset avokuese për të adresuar ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, si çështje të rëndësishme për të ardhmen e planetit dhe brezave të ardhshëm.


EKO KLUBET VIZITOJNË IMPIANTIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA NË PRIZREN

Gjatë këtyre vizitave, nxënësit janë njoftuar me mënyrën e menaxhimit të këtij impianti, por edhe trajtimin e ujërave të ndotura duke përfshirë proceset e filtrimit dhe pastrimit të ujit të ndotur, teknologjitë e përdorura për trajtimin e ujërave dhe rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Ata gjithashtu u informuan për kapacitetin e impiantit në Prizren, sasinë e ujit që trajtohet çdo ditë, dhe llojet e ndotësve që largohen gjatë procesit të trajtimit.

Vizitat kanë përfshirë edhe diskutime mbi ndikimin mjedisor dhe shëndetësor të trajtimit të duhur të ujërave të ndotura, si dhe rolin që ka komuniteti në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.



PLANET E VEPRIMIT MJEDISOR PËR 12 SHKOLLAT E MESME TË RAJONIT TË JUGUT




EC Ma Ndryshe ka publikuar planet e veprimit mjedisor për 12 shkollat e mesme të larta të Rajonit të Jugut. Këto plane janë hartuar në bashkëpunim me profesorët dhe anëtarët e Eko-klubeve gjatë një serie të punëtorive të realizuara.

Gjatë këtyre punëtorive nxënësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë dhe të identifikojnë problemet ekzistuese në shkollë dhe komunitet dhe kanë treguar aktivitetet që i realizojnë dhe që do të donin ti realizonin për ti zgjidhur problemet që ndërlidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Këto plane janë të rëndësishme për ti edukuar nxënësit rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe për të krijuar një kulturë të qëndrueshme brenda komunitetit të shkollës. Ato do t'u shërbejnë shkollave si udhërrëfyes për realizimin e aktiviteteve të ardhshme, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

REALIZIMI I PROJEKTIT MJEDISOR

Eko klubi i shkollës së muzikës “Lorenc Antoni” në Prizren ka realizuar projektin mjedisor. Me anë të këtij projekti nxënësit kanë rritur hapësirën e gjelbër në shkollën e tyre duke mbjellur drunjë dhe bimë shumëvjeçare, kanë ndikuar në efikasitetin e shkollës duke vendosur panele solare dhe kanë vendosur myshqe të gjalla në hapsirat mbrenda objektit për të pasuruar objektin më shumë me ajër të pastër dhe të gjelbërt. Qëllim i këtij projekti përveç tjerash ishte edhe aktivizimi mjedisor i nxënësve, të cilët gjatë aktivitetit ndihmuan në procesin e mbjelljes së drunjëve dhe kanë pastruar hapësirën përreth shkollës, duke i bërë kështu të ndjehen përgjegjës për intervenimin e realizuar.



EKO KLUBI "LORENC ANTONI"

RR. MARIN BARLETI, PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -



EKO KLUBI "YMER PRIZRENI"

4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e katërt e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Ymer Prizreni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

RICIKLIMI

Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave. Kohët e fundit ky proces ka një zhvillim të gjerë në shumë fusha industriale: të hekurit, drurit, plastikës, të qelqit (për të përmendur këtu më të rëndësishmet). Për të bërë sa më të thjeshtë këtë proces dhe ripërfitim të materialeve të riciklueshme është vënë në funksion grumbullimi i diferencuar i mbeturinave në kontenitoret përkatës: letër, qelq, plastikë apo mbetjet e njoma (që janë mbetjet ushqimore). Riciklimi i mbeturinave ndihmon planetin tonë. Grumbullimi i mbeturinave sjell një mjedis më të pastër për ne e fëmijët tanë, kurse riciklimi i tyre mbron burimet e pasurisë natyrore që të mos shterojnë kurrë. RIPËRDORIMI, REDUKTIMI, RICIKLIMI...janë 3 fjalët më të rëndësishme që ndihmojnë natyrën dhe mjedisin ku jetojmë. Riciklimi bëhet i mundur falë ndihmës tonë. Jemi ne ata që duhet të diferencojmë fillimisht mbeturinat që prodhojmë. Për të bërë një grumbullim të diferencuar sa më efektiv, është e rëndësishme të njohim cilat janë materialet e riciklueshme dhe si duhet ti ndajmë ato. Riciklimi i letrës hap pas hapi 1- Mblidhen mbetjet e letrës nga vendgrumbullimet e mbetjeve. 2- Letra futet në kazana me ujë. 3- Ndahen fibrat e letrës nga mbetjet e tjera si bojë, papastërti etj. 4- Lënda e formuar thahet dhe i jepet formë duke e presuar. 5- Formohet kështu letra e re e gatshme për përdorim. Letra nuk mund të riciklohet deri në pafundësi. Fibrat e letrës pas çdo riciklimi vinë e shkurtohen duke ulur kështu cilësinë e letrës. P:SH Një kuti kartoni mund të riciklohet deri në gjashtë herë.

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE NDIKIMI NË JETËN E PËRDITSHME

Ndryshimet klimatike janë një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet bota sot. Temperaturat në rritje, modelet e ndryshuara të reshjeve dhe ngjarjet ekstreme të motit ndikojnë në furnizimin me ushqim, ujin e pijshëm dhe habitatet natyrore. Për shumë njerëz, këto ndryshime përkthehen në vështirësi ekonomike dhe sfida për mbijetesën. Lufta kundër ndryshimeve klimatike kërkon veprime të bashkërenduara në nivel lokal dhe global për të reduktuar emetimet e gazeve serrë dhe për të promovuar mënyra jetese të qëndrueshme.





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

EKO KLUBET MËSOJNË PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE PËR FORMAT E AVOKIMIT
MJEDISOR



AKTIVITETET E EKO- KLUBIT:

EC-I ME EKO-KLUBET SHËNOI DITËN BOTËRORE TË MJEDISIT

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 12 Eko-Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (nga komunat Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë).

Shfaqja e filmit është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të Eko-Klubeve mbi çështjet mjedisore dhe urgjencën për veprim lidhur me ndryshimet klimatike, tema këto të trajtuara edhe në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti të rinjtë janë ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e një reagimi të shpejtë sikurse edhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset avokuese për të adresuar ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, si çështje të rëndësishme për të ardhmen e planetit dhe brezave të ardhshëm.



EKO KLUBET VIZITOJNË IMPIANTIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA NË PRIZREN




Gjatë këtyre vizitave, nxënësit janë njoftuar me mënyrën e menaxhimit të këtij impianti, por edhe trajtimin e ujërave të ndotura duke përfshirë proceset e filtrimit dhe pastrimit të ujit të ndotur, teknologjitë e përdorura për trajtimin e ujërave dhe rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Ata gjithashtu u informuan për kapacitetin e impiantit në Prizren, sasinë e ujit që trajtohet çdo ditë, dhe llojet e ndotësve që largohen gjatë procesit të trajtimit.

Vizitat kanë përfshirë edhe diskutime mbi ndikimin mjedisor dhe shëndetësor të trajtimit të duhur të ujërave të ndotura, si dhe rolin që ka komuniteti në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.



PLANET E VEPRIMIT MJEDISOR PËR 12 SHKOLLAT E MESME TË RAJONIT TË JUGUT



EC Ma Ndryshe ka publikuar planet e veprimit mjedisor për 12 shkollat e mesme të larta të Rajonit të Jugut. Këto plane janë hartuar në bashkëpunim me profesorët dhe anëtarët e Eko-klubeve gjatë një serie të punëtorive të realizuara.

Gjatë këtyre punëtorive nxënësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë dhe të identifikojnë problemet ekzistuese në shkollë dhe komunitet dhe kanë treguar aktivitetet që i realizojnë dhe që do të donin ti realizonin për ti zgjidhur problemet që ndërlidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Këto plane janë të rëndësishme për ti edukuar nxënësit rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe për të krijuar një kulturë të qëndrueshme brenda komunitetit të shkollës. Ato do t'u shërbejnë shkollave si udhërrëfyes për realizimin e aktiviteteve të ardhshme, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

REALIZIMI I PROJEKTIT MJEDISOR

Eko klubi i shkollës së mesme “Ymer Prizreni” në Prizren ka realizuar projektin mjedisor. Me anë të këtij projekti nxënësit kanë rritur hapësirën e gjelbër në shkollën e tyre duke mbjellur drunjë dhe bimë shumëvjeçare, kanë vendosur shporta për riciklim të mbeturinave dhe parkingje të biçikletave. Qëllim i këtij projekti përveç tjerash ishte edhe aktivizimi mjedisor i nxënësve, të cilët gjatë aktivitetit ndihmuan në procesin e mbjelljes së drunjëve dhe kanë pastruar hapësirën përreth shkollës, duke i bërë kështu të ndjehen përgjegjës për intervenimin e realizuar.



EKO KLUBI "YMER PRIZRENI"

RR. IMEHMET PASHË DEVALLA, PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".

EC
MA NDRYSHE



EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI

"UKSHIN HOTI"



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e katërt e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Ukshin Hoti" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



UJI DHE KRIZA KLIMATIKE GLOBALE: DISA FAKTE QË DUHET TË DINI...

- Ndryshimet klimatike po prishin modelet e motit, duke çuar në ngjarje ekstreme, disponueshmëri të paparashikueshme të ujit, përkeqësim të mungesës së ujit dhe ndotje të furnizimeve me ujë. Këto efekte mund të ndikojnë në mënyrë drastike në sasinë dhe cilësinë e ujit që u nevojitet fëmijëve për të mbijetuar.
- Aktualisht, një ndryshim në klimë ndihet kryesisht përmes ndryshimit të ujit. Miliona fëmijë janë në rrezik.
- Ngjarjet ekstreme të motit dhe ndryshimet në modelet e ciklit të ujit e bëjnë të vështirë qasjen në ujë të pijshëm të sigurt, veçanërisht për fëmijët.
- Rreth 74% e fatkeqësive natyrore midis 2001 dhe 2018 ishin të lidhura me ujin, duke përfshirë thatësitat dhe përmbytjet. Frekuenca dhe intensiteti i këtyre ngjarjeve pritet të rritet me ndryshimet klimatike.
- Përafërsisht 450 milionë fëmijë jetojnë në zona me cenueshmëri të lartë ose jashtëzakonisht të lartë ndaj ujit. Kjo do të thotë se ata nuk kanë ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e tyre ditore.
- Kur ndodhin katastrofa, ato mund të shkatërrojnë ose ndotin të gjithë furnizimet me ujë, duke rritur rrezikun e sëmundjeve të tilla si kolera dhe tifoja, ndaj të cilave fëmijët janë veçanërisht të prekshëm.
- Rritja e temperaturave mund të çojë në shfaqjen e patogjenëve vdekjeprurës në burimet e ujërave të ëmbla, duke e bërë ujin të rrezikshëm për popullatën



UJI DHE KRIZA KLIMATIKE GLOBALE: DISA FAKTE QË DUHET TË DINI...

- Uji i ndotur përbën një kërcënim të madh për jetën e fëmijëve. Sëmundjet e lidhura me ujin dhe kanalizimet janë një nga shkaqet kryesore të vdekjes tek fëmijët nën 5 vjeç.
- Çdo ditë, më shumë se 700 fëmijë nën 5 vjeç vdesin nga diarreja e lidhur me ujin, kanalizimet dhe higjenën e dobët.
- Ndryshimet klimatike përkeqësojnë menaxhimin e ujit – zona me burime ujore jashtëzakonisht të kufizuara – duke çuar në rritjen e konkurrencës për ujë, madje edhe në konflikt.
- Deri në vitin 2040, gati 1 në 4 fëmijë do të jetojnë në zona me probleme të mëdha të ujit.
- Rritja e nivelit të detit po bën që uji i ëmbël të bëhet i kripur, duke rrezikuar burimet ujore ku mbështeten miliona njerëz.

Përshtatja me efektet e ndryshimeve klimatike në ujë do të mbrojë shëndetin e fëmijëve dhe do të shpëtojë jetën e tyre. Përdorimi i ujit në mënyrë më efikase dhe kalimi në sistemet e ujit me energji diellore do të reduktojë gazrat serë dhe do të mbrojë më tej të ardhmen e fëmijëve



AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

EKO KLUBET MËSOJNË PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE PËR FORMAT E AVOKIMIT
MJEDISOR



AKTIVITETET E EKO- KLUBIT:

EC-I ME EKO-KLUBET SHËNOI DITËN BOTËRORE TË MJEDISIT



Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 12 Eko-Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (nga komunat Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë).

Shfaqja e filmit është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të Eko-Klubeve mbi çështjet mjedisore dhe urgjencën për veprim lidhur me ndryshimet klimatike, tema këto të trajtuara edhe në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti të rinjtë janë ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e një reagimi të shpejtë sikurse edhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset avokuese për të adresuar ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, si çështje të rëndësishme për të ardhmen e planetit dhe brezave të ardhshëm.




EKO KLUBET VIZITOJNË IMPIANTIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA NË PRIZREN

Gjatë këtyre vizitave, nxënësit janë njoftuar me mënyrën e menaxhimit të këtij impianti, por edhe trajtimin e ujërave të ndotura duke përfshirë proceset e filtrimit dhe pastrimit të ujit të ndotur, teknologjitë e përdorura për trajtimin e ujërave dhe rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Ata gjithashtu u informuan për kapacitetin e impiantit në Prizren, sasinë e ujit që trajtohet çdo ditë, dhe llojet e ndotësve që largohen gjatë procesit të trajtimit.

Vizitat kanë përfshirë edhe diskutime mbi ndikimin mjedisor dhe shëndetësor të trajtimit të duhur të ujërave të ndotura, si dhe rolin që ka komuniteti në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.



PLANET E VEPRIMIT MJEDISOR PËR 12 SHKOLLAT E MESME TË RAJONIT TË JUGUT



EC Ma Ndryshe ka publikuar planet e veprimit mjedisor për 12 shkollat e mesme të larta të Rajonit të Jugut. Këto plane janë hartuar në bashkëpunim me profesorët dhe anëtarët e Eko-klubeve gjatë një serie të punëtorive të realizuara.

Gjatë këtyre punëtorive nxënësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë dhe të identifikojnë problemet ekzistuese në shkollë dhe komunitet dhe kanë treguar aktivitetet që i realizojnë dhe që do të donin ti realizonin për ti zgjidhur problemet që ndërlidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Këto plane janë të rëndësishme për ti edukuar nxënësit rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe për të krijuar një kulturë të qëndrueshme brenda komunitetit të shkollës. Ato do t'u shërbejnë shkollave si udhërrëfyes për realizimin e aktiviteteve të ardhshme, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

EKO KLUBI "UKSHIN HOTI"

KRUSHË E MADHE, RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".

EC
MA NDRYSHE



EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -

EKO KLUBI

"12 MAJI"

4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e katërt e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë “12 Maji” dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “ECO School”.

Ky projekt do t’i njohë me konceptin “Eko Shkolla” 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).




TEMPERATURA E RRITUR

Pritet që temperatura mesatare vjetore të rritet çdo vit: deri në vitin 2040 temperatura mesatare do të jetë $1,5^{\circ}$ C më e lartë. Kjo mund të duket e parëndësishme, por kjo rritje do të ndryshojë kushtet e jetesës për të gjithë.

EFEKTI SERË

Efekti serë është pasojë e një çekuilibrimi të energjisë (nxehësisë) ndërmjet sasisë së nxehësisë që Toka merr nga Dielli dhe sasisë që ajo çliron sërish në hapësirë. Ngrohja globale ndodh si rezultat i emetimeve të tepërta të gazeve serë (GS), si dioksidi i karbonit, metani, klorofuorokarburet, oksidet e azotit dhe të tjera që thithin rrezatimin diellor dhe mbajnë nxehësinë. Me pak fjalë, efekti serë është ngrohja e pakontrolluar e atmosferës së Tokës. Djegia e lëndëve djegëse fosile (qymyri, nafta dhe gazi natyror) është burimi më i madh i emetimeve të gazeve serë.



FLORA E NDRYSHUAR

Ndryshimet klimatike, të tilla si thatësirat dhe rritja e temperaturave mesatare ose ndryshimet ekstreme të temperaturës (rënia dhe ngritja e papritur e temperaturës gjatë një periudhe të shkurtër kohore) mund të shkaktojnë zhdukjen e disa llojeve bimore në zona të caktuara. Ndryshimet klimatike, në kombinim me faktorë të tjerë, do të çojnë në shfaqjen dhe përhapjen e llojeve bimore aspak karakteristike për zona të caktuara (p.sh. lloje invazive si ambrozia). Zhdukja e llojeve bimore nga natyra rrezikon furnizimin me lëndë të para për barna, ushqim dhe nevoja të tjera të njeriut, gjë që kërcënon drejtpërdrejt mbijetesën e tij. Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) krijoi Listën e Kuqe të Llojeve të Kërcënuara™, një listë që përfshin të gjitha llojet bimore të kërcënuara me zhdukje në rang global.

FAUNA E NDRYSHUAR

Ndryshimet klimatike, të tilla si thatësirat dhe rritja e temperaturave mesatare ose ndryshimet ekstreme të temperaturës (rënie dhe rritje e papritur e temperaturës për një periudhë të shkurtër kohore), çojnë në zvogëlimin e popullatave dhe/ose zhdukjen e llojeve të caktuara të kafshëve. Zhdukja e disa kafshëve në natyrë ndërpret zinxhirin ushqimor, duke shkaktuar çrregullime të ekosistemit. Për më tepër, zvogëlimi i popullatave ose zhdukja e plotë e llojeve nga natyra zvogëlon diversitetin gjenetik që siguron që kafshët të jenë më rezistente ndaj sëmundjeve dhe të përshtaten më mirë ndaj kushteve të ndryshuara mjedisore.

TERRENI I NDRYSHUAR

Zonat e ekspozuara ndaj ndryshimeve të zgjatura ose intensive të kushteve klimatike dhe pasojave të tyre (temperatura jashtëzakonisht të ulëta ose të larta, etj.) mund të degradohen pjesërisht ose plotësisht. Ndryshimet në terren janë shpesh rezultat i proceseve të erozionit, në një shkallë më të vogël ose më të madhe. Degradimi i tokës çon në ndryshime në terren, duke i bërë shpesh këto zona të pakapërcyeshme për shkak të zhdukjes së shpateve të buta, krijimit të grykave, zhdukjes së materialit të dyshemesë që lejon lëvizjen e sigurt, grumbullimit të aluvioneve të imëta ose të trasha dhe zëvendësimit të tokës pjellore me material jopjellor. Relievi i ndryshuar gjithashtu ndryshon kushtet e jetesës për llojet bimore dhe shtazore.

THATËSIRA

Thatësira është një nga pasojat më të rëndësishme të ndryshimeve klimatike, duke shkaktuar zhdukjen e llojeve të shumta bimore dhe shtazore, si dhe migrimin e njerëzve. Burimet e ujit të pijshëm dhe puset e krijuara në mënyrë të pavarur thahen më shpesh në verë. Çrregullimet në cilësinë e ujit janë të zakonshme, pasi nivelet e ulëta ose jashtëzakonisht të larta të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore mund të kontaminojnë ujin e pijshëm, duke e bërë atë të papërshtatshëm për t'u konsumuar. Çrregullimet në regjimin ujqor të tokës bëjnë që toka të thahet, një nga hapat e parë të shkretëtirëzimit. Si rezultat, toka bëhet e papërshtatshme për kultivimin e të korrave dhe mbijetesën e bimësisë në përgjithësi.



AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

EKO KLUBET MËSOJNË PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE PËR FORMAT E AVOKIMIT
MJEDISOR



AKTIVITETET E EKO- KLUBIT:

EC-I ME EKO-KLUBËT SHËNOI DITËN BOTËRORE TË MJEDISIT

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 12 Eko-Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (nga komunat Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë).

Shfaqja e filmit është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të Eko-Klubeve mbi çështjet mjedisore dhe urgjencën për veprim lidhur me ndryshimet klimatike, tema këto të trajtuara edhe në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti të rinjtë janë ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e një reagimi të shpejtë sikurse edhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset avokuese për të adresuar ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, si çështje të rëndësishme për të ardhmen e planetit dhe brezave të ardhshëm.



EKO KLUBET VIZITOJNË IMPIANTIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA NË PRIZREN




Gjatë këtyre vizitave, nxënësit janë njoftuar me mënyrën e menaxhimit të këtij impianti, por edhe trajtimin e ujërave të ndotura duke përfshirë proceset e filtrimit dhe pastrimit të ujit të ndotur, teknologjitë e përdorura për trajtimin e ujërave dhe rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Ata gjithashtu u informuan për kapacitetin e impiantit në Prizren, sasinë e ujit që trajtohet çdo ditë, dhe llojet e ndotësve që largohen gjatë procesit të trajtimit.

Vizitat kanë përfshirë edhe diskutime mbi ndikimin mjedisor dhe shëndetësor të trajtimit të duhur të ujërave të ndotura, si dhe rolin që ka komuniteti në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.



PLANET E VEPRIMIT MJEDISOR PËR 12 SHKOLLAT E MESME TË RAJONIT TË JUGUT



EC Ma Ndryshe ka publikuar planet e veprimit mjedisor për 12 shkollat e mesme të larta të Rajonit të Jugut. Këto plane janë hartuar në bashkëpunim me profesorët dhe anëtarët e Eko-klubeve gjatë një serie të punëtorive të realizuara.

Gjatë këtyre punëtorive nxënësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë dhe të identifikojnë problemet ekzistuese në shkollë dhe komunitet dhe kanë treguar aktivitetet që i realizojnë dhe që do të donin ti realizonin për ti zgjidhur problemet që ndërlidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Këto plane janë të rëndësishme për ti edukuar nxënësit rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe për të krijuar një kulturë të qëndrueshme brenda komunitetit të shkollës. Ato do t'u shërbejnë shkollave si udhërrëfyes për realizimin e aktiviteteve të ardhshme, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

EKO KLUBI "12 MAJI"

RATKOC, RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -



EKO KLUBI

"LASGUSH PORADECI"




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e katërt e buletineve mjedisore të eko-klubevetë shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Lasgush Poradeci" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS NË KOSOVË

Zonat e mbrojtura të natyrës në Kosovë më 2014 ishin 116 sosh duke mbuluar një sipërfaqe prej 118.913,95 ha (10.9% e sipërfaqes të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate Strikte të Natyrës (“Bifurkacioni i lumit Nerodime”, “Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, “Kamilja”, etj), 2 Parqe Kombëtare (PK “Sharri”, PK “Bjeshkët e Nemuna”), 99 Monumente të Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit”, “Shpella e Gadimës”, “Ujvarat e Mirushës”, “Gryka e Rugovës”, “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë”, “Trungu i Rrapit në Marash” etj), 1 Park Regjional i Natyrës (“Gërmia”), 2 peizazhe të Mbrojtura (“Shkugëza” dhe “Pishat e Deçanit”) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (“Ligatina e Hencit-Radeves”).[1]

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri”.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është institucioni qendror për ruajtjen e natyrës, monitorimin e gjendjes së vlerave të mbrojtura natyrore në Kosovë.



REZERVATET STRIKTE TË NATYRËS

Rezervati strikt i natyrës është zonë e tokës dhe/ose ujit e pandryshuar ose shumë pak e ndryshuar dhe është i dedikuar ekskluzivisht për ruajtjen e natyrës së paprekur, hulumtime shkencore të larmisë biologjike, përcjelljen e gjendjes së natyrës si dhe arsimimit nëse nuk rrezikojnë zhvillimin e lirshëm të proceseve natyrore. Për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt duhet të merret leja nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në rezervatin strikt ndalohet kryerja e veprimtarive ekonomike dhe veprimtarive të tjera. Për rezervatet strikte të natyrës vlen shkalla e I-rë e mbrojtjes dhe ato shpallën nga Qeveria. Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura, rezervatet natyrore përfshijnë 847 ha. Në Kosovë deri më tash kemi 3 lloje të rezervateve të mbrojtura: rezervate bimore (7), rezervate shtazore (2) dhe rezervate speciale (2).

Në Kosovë ekzistojnë 11 rezervate të natyrës me sipërfaqe të përgjithshme prej 847 ha ose 0.68 % e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Prej tyre 4 rezervateve gjenden në brendësi të Parkut Kombëtar “Sharri” (Maja e Arnenit, Rusenica, Pisha e Madhe dhe Oshlaku), 4 gjenden në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (Kozhnjeri, Gubavci, Malet e Prilepit dhe Maja e Ropsit) si dhe 3 rezervate tjera (Bifurkacioni i lumit Nerodime, kodrina e Kamiljes dhe Gazimestani).



PARQET KOMBËTARE

Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen e vlerave burimore të natyrës.

Parku kombëtar ka rëndësi shkencore, kulturore, edukativo arsimore dhe rekreative. Në parkun kombëtar lejohen punët dhe veprimtaritë me të cilat nuk rrezikohet natyra burimore. Në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës.

Në parkun kombëtar lejohen veprimtaritë hoteliere – turistike dhe rekreative të cilat janë në funksion të vizitave, arsimimit, të nevojave shëndetësore – rekreative dhe turistike, bujqësia ekstensive tradicionale, peshkataria nëse nuk rrezikohet ekzistenca e llojeve dhe baraspesha natyrore në pajtim me Ligjin e natyrës dhe planin e menaxhimit.

Në Kosovë ekzistojnë dy Parqe Kombëtare të shpallura nga Kuvendi i Kosovës: PK “Sharri” me sipërfaqe 53 469 ha dhe PK “Bjeshkët e Nemuna” me 62.488 ha. Parqet kombëtare përfshijnë gjithsej 115.957 ha.



ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA

Zona e veçantë e mbrojtur është zonë e tokës dhe/ose ujit me rëndësi të veçantë për shkak se është unike, e rrallë - reprezentative, ose është vendbanim i llojeve të egra dhe veçanërisht është i rëndësishëm për hulumtime shkencore.

Zona e veçantë mundet me qenë: bimore, mikologjike, e vegjetacionit pyjor, zoologjike - ornitologjike, ihtiologjike, gjeologjike, paleontologjike, hidrogjeologjike, hidrologjike etj. Në zonën e veçantë nuk lejohen ndërhyrjet, punët dhe veprimtaritë të cilat mundën me ia prishë veçoritë për shkak të cilave është shpallë zonë e veçantë - grumbullimi dhe shkatërrimi i bimëve, shqetësimi, kapja dhe vrasja e shtazëve, futja e llojeve të reja biologjike, ndërhyrjet melioruse, llojet e ndryshme të ekonomizimit dhe shfrytëzimi tjetër e të ngjashme.

Në zonën e veçantë janë të lejuara ndërhyrjet, punët dhe veprimtaritë me të cilat mbahen ose përmirësohen kushtet të rëndësishme për ruajtjen e veçorive për shkak të cilave është shpallë zona. Në Kosovë ekziston një Zonë e Veçantë e Mbrojtur e zogjve - Ligatina e Hencit - Radeves me sipërfaqe 109 ha.





MONUMENTET E NATYRËS

Monumenti i natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.

Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura në Kosovë, Monumentet e Natyrës për nga numri zënë vendin e parë me 99 sosh, ndërsa për nga sipërfaqja vendin e dytë me 5.971.95 ha. Prej tyre 2 Monumente janë të Rëndësisë së Veçantë, (Ujëvarat e Mirushës dhe Shpella e Gadimes), 66 të karakterit botanik, 17 hidrologjik, 7 gjeomorfologjik, 9 speologjik.

Monumentet e natyrës në të cilat ka pas ndikime më të mëdha gjatë këtyre tri viteve të fundit janë: Shpella e Gadimes, Ujëvarat e Mirushës, Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit, etj.

PEIZAZHET E MBROJTURA

Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion.

Në peizazhin e mbrojtur nuk lejohen ndërhyrjet dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallë i mbrojtur. Në kuadër të kësaj kategorie hyjnë Parku Regjional Gërmia me sipërfaqe prej 1.126 ha, Parku i Shkugëzes me sipërfaqen prej 70 ha dhe Pishat e Deçanit me 15 ha. Gjithsej 1.211 ha.

MONUMENTET E ARKITEKTURËS SË PARKUT

Monumenti i arkitekturës së parkut është hapësirë e krijuar artificialisht - kopshti botanik, arboretumi, parku i qytetit, dru radhitjet, si dhe format tjera të kopshteve dhe parqeve, përkatësisht trungje individuale ose grupe trungjesh që kanë vlerë të madhe estetike, kulturo-historike, ekologjike ose shkencore.

Në monumentin e arkitekturës së parkut dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij e cila është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk janë të lejuara veprimtaritë ose punët të cilat mund të ndryshojnë ose të prishin vlerat për shkak të cilave është mbrojtur. Në kuadër të kësaj kategorie të mbrojtjes ende nuk është klasifikuar asnjë zonë e mbrojtur.





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

EKO KLUBET MËSOJNË PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE PËR FORMAT E AVOKIMIT
MJEDISOR



AKTIVITETET E EKO- KLUBIT:

EC-I ME EKO-KLUBET SHËNOI DITËN BOTËRORE TË MJEDISIT

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 12 Eko-Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (nga komunat Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë).

Shfaqja e filmit është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të Eko-Klubeve mbi çështjet mjedisore dhe urgjencën për veprim lidhur me ndryshimet klimatike, tema këto të trajtuara edhe në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti të rinjtë janë ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e një reagimi të shpejtë sikurse edhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset avokuese për të adresuar ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, si çështje të rëndësishme për të ardhmen e planetit dhe brezave të ardhshëm.




EKO KLUBET VIZITOJNË IMPIANTIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA NË PRIZREN

Gjatë këtyre vizitave, nxënësit janë njoftuar me mënyrën e menaxhimit të këtij impianti, por edhe trajtimin e ujërave të ndotura duke përfshirë proceset e filtrimit dhe pastrimit të ujit të ndotur, teknologjitë e përdorura për trajtimin e ujërave dhe rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Ata gjithashtu u informuan për kapacitetin e impiantit në Prizren, sasinë e ujit që trajtohet çdo ditë, dhe llojet e ndotësve që largohen gjatë procesit të trajtimit.

Vizitat kanë përfshirë edhe diskutime mbi ndikimin mjedisor dhe shëndetësor të trajtimit të duhur të ujërave të ndotura, si dhe rolin që ka komuniteti në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.



PLANET E VEPRIMIT MJEDISOR PËR 12 SHKOLLAT E MESME TË RAJONIT TË JUGUT



EC Ma Ndryshe ka publikuar planet e veprimit mjedisor për 12 shkollat e mesme të larta të Rajonit të Jugut. Këto plane janë hartuar në bashkëpunim me profesorët dhe anëtarët e Eko-klubeve gjatë një serie të punëtorive të realizuara.

Gjatë këtyre punëtorive nxënësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë dhe të identifikojnë problemet ekzistuese në shkollë dhe komunitet dhe kanë treguar aktivitetet që i realizojnë dhe që do të donin ti realizonin për ti zgjidhur problemet që ndërlidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Këto plane janë të rëndësishme për ti edukuar nxënësit rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe për të krijuar një kulturë të qëndrueshme brenda komunitetit të shkollës. Ato do t'u shërbejnë shkollave si udhërrëfyes për realizimin e aktiviteteve të ardhshme, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

EKO KLUBI "LASGUSH PORADECI" **KIJEVË, MALISHEVË**

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOËLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -



EKO KLUBI "LUCIANO MOTRONI"

4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e katërt e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Luciano Motroni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.


Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

KONSUMI I ENERGJISË

Trajnimi i Modeleve të Mëdha: Modelet e mëdha të IA, si ato që përdoren në përpunimin e gjuhës natyrore dhe në mësimin e thellë (deep learning), kërkojnë shumë burime kompjuterike. Për shembull, trajnimi i një modeli të madh gjuhësor mund të kërkojë energji të barabartë me konsumin vjetor të disa shtëpive. Ky përdorim i lartë i energjisë kontribuon në emetimet e karbonit, veçanërisht nëse energjia vjen nga burime jo të rinovueshme si qymyri dhe gazi natyror.


Qendrat e të Dhënave: Qendrat e të dhënave që ruajnë dhe përpunojnë të dhëna për aplikacionet e IA funksionojnë 24/7 dhe kërkojnë ftohje të vazhdueshme, duke konsumuar kështu më shumë energji.



BURIMET NATYRORE

Nxjerrja e Metaleve të Rralla: Prodhimi i pajisjeve elektronike, si serverët dhe procesorët e përdorur në IA, kërkon metale të rralla si litiumi dhe kobalti. Nxjerrja dhe përpunimi i këtyre materialeve mund të dëmtojë ekosistemet lokale, të ndotë ujin dhe të shkaktojë erozion të tokës.

Kostoja Mjedisore e Prodhimit: Proceset e prodhimit të çipave kompjuterikë dhe komponentëve të tjerë elektronikë janë intensive në përdorimin e ujit dhe kimikateve, të cilat mund të kenë një ndikim negativ në mjedis nëse nuk menaxhohen siç duhet.





MBETJET ELEKTRONIKE DHE NDIKIMI NË EKOSISTEME

Jetëgjatësia e Shkurtër e Pajisjeve: Teknologjitë IA zhvillohen me ritme të shpejta, duke bërë që pajisjet të vjetrohen shpejt. Kjo çon në rritjen e mbetjeve elektronike, të cilat përmbajnë substanca të dëmshme për mjedisin.

Riciklimi i Papërshtatshëm: Shumë prej këtyre mbetjeve nuk riciklohen siç duhet, duke përfunduar në landfille dhe duke kontribuar në ndotjen e tokës dhe ujit me substanca toksike.

Bujqësia e Intensifikuar: Përdorimi i IA në bujqësi mund të çojë në rritjen e përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike për të maksimizuar prodhimin. Kjo mund të shkaktojë ndotje të ujërave dhe tokës, duke ndikuar negativisht në biodiversitet.

Shfrytëzimi i Burimeve Ujore: Teknologjitë IA mund të përdoren për të rritur efikasitetin e përdorimit të ujit, por gjithashtu mund të çojnë në shfrytëzim të tepërt të burimeve ujore nëse nuk menaxhohen me kujdes.



ASPEKTET POZITIVE TË IA PËR MJEDISIN

Përveç ndikimeve negative, IA mund të ofrojë zgjidhje për disa probleme mjedisore:

1. Optimizimi i Konsumit të Energjisë: IA mund të ndihmojë në optimizimin e konsumit të energjisë në ndërtesa dhe industri, duke reduktuar emetimet e karbonit.
2. Monitorimi i Mjedisit: Teknologjitë IA mund të përdoren për të monitoruar në kohë reale cilësinë e ajrit dhe ujit, si dhe për të detektuar ndryshimet në ekosisteme.
3. Menaxhimi i Burimeve Natyrore: IA mund të ndihmojë në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe burimeve të tjera natyrore, duke ndihmuar në ruajtjen e biodiversitetit.

PERFUNDIM

Ndikimi i IA në mjedis varet nga mënyra se si përdoret teknologjia. Për të minimizuar ndikimet negative, është e rëndësishme që zhvilluesit dhe përdoruesit e IA të kenë parasysh praktikatat e qëndrueshme, si përdorimi i energjisë së rinovueshme dhe riciklimi i duhur i pajisjeve elektronike. Ndërkohë, përfitimet e IA mund të maksimizohen duke përdorur teknologjinë për të zgjidhur sfida të rëndësishme mjedisore.



AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

EKO KLUBET MËSOJNË PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE PËR FORMAT E AVOKIMIT
MJEDISOR



EKO KLUBET VIZITOJNË IMPIANTIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA NË PRIZREN

